REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr.2456/1 Prot

Lushnje, më 18/03/2024

PROJEKT VENDIM
Nr. 39, datë 18.03.2024

Për miratimin e dokumentit të **"Planit të Gadishmerisë për përballimin e Emergjencave Civile",** në teritorin e Bashkisë , Lushnje.

Në mbështetje të nenit 3, **"Misioni i vetëqeverisjes vendore ",** të nenit 9,**"Të drejtat dhe përgjegjësitë "** dhe nenit 29 **"Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike",** të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 ***"Për Vetëqeverisjen Vendore",*** nenit 8 ***"Zvogëlimi i Riskut nga Fatkeqësitë",*** nenit 9 ***"Vlerësimi i Riskut",*** nenit 10 **"Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë",** nenit 11**"Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë"** nenit 12**" Harmonizimi i planeve të zhvillimit urban me strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë",** nenit 13**"Vërtetimi i riskut",** nenit 14 **"Planet për emergjencat civile ",** si dhe të nenit 30 pika ç të Kreut II ***"Zvogëlimi i Riskut nga Fatkeqësitë",*** si dhe të nenit 30***"Bashkitë",*** të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 ***"Për Mbrojtjen Civile"***, për hartimin dhe miratimin e dokumentit të **"Planit të Gadishmerisë për përballimin e Emergjencave Civile"**, në teritorin e saj, Bashkia Lushnje,

PROPOZON:

1. Miratimin e dokumentit të **"Planit të Gadishmerisë për përballimin e Emergjencave Civile"** në teritorin e Bashkisë , Lushnje. sipas kërkesave të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 ***"Për Vetëqeverisjen Vendore"*** dhe ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 ***"Për Mbrojtjen Civile"*** neni 30 pika ç.
2. Shumëfishimin dhe arshivimin e këtij dokumenti si dokument themelor dhe i rëndësishëm për punën e kësaj bashkie në të ardhmen, në Planifikimin e Zhvillimit Urban.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Shërbimeve (sektori i Emergjencave Civile) dhe drejtoria e përgjithshme e Financës, Buxhetit, Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Pronave.

Drejtoria e Shërbimeve
ELTON KOROVESHI

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETARE
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE